

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Auditimi i avancuar dhe
siguria**

P10

Data 28/01/2023

Detyra 1

Ju jeni një menaxher në departamentin e auditimit të HanSolo ShPK, një firmë e auditimit, përgjegjës për auditimin e disa kompanive dhe për vlerësimin e vendimeve të pranimit në lidhje me klientët e rinj të mundshëm të auditimit.

Një nga klientët tuaj të auditimit është SportKos SHA, e cila operon një zinxhir qendrash sporti dhe argëtimi në të gjithë vendin.

Kompania ka një vit financiar që përfundon më 28 shkurt 2022, dhe ju jeni gati të filloni planifikimin e auditimit. Vlora Kema, partnerja e angazhimit të auditimit, u takua me drejtorin financiar të kompanisë javën e kaluar për të diskutuar zhvillimet e biznesit gjatë vitit dhe performancën e fundit financiare.

Më poshtë janë ofruar shtojcat përkatëse:

1. Një email që keni marrë nga Vlora Kema, në lidhje me SportKos SHA.
2. Shënime të një takimi që Stella zhvilloi së fundmi me drejtorin e financave të SportKos.
3. Ekstrakte nga pasqyrat më të fundit të menaxhimit të SportKos.

Kërkohet:

Përgjigjuni udhëzimeve në email nga partnerja e angazhimit të auditimit. (32 pikë)

Shënim: Ndarja e pikëve tregohet në emailin e partnerit (Shtojca 1).

Pikë profesionale do të jepen për paraqitjen dhe rrjedhën logjike të shënimeve informuese dhe qartësinë e shpjegimeve të dhëna. (3 pikë)

(Gjithsej: 35 pikë)

Shtojca 1 – Email nga partneri i angazhimit të auditimit

Për: Menaxherin e auditimit

Nga: Vlora Kema, partnere e angazhimit të auditimit për SportKos

Tema: Planifikimi i auditimit për SportKos,

Përshëndetje,

Unë ju kam ofruar disa informacione në formën e një numri shtojcash që duhet t'i përdorni për t'ju ndihmuar në planifikimin e auditimit të SportKos për vitin financiar që përfundon më 28 shkurt 2022.

Duke përdorur informacionin e dhënë në Shtojcat 2 dhe 3, ju kërkoj të përgatisni shënime informuese për përdorimin tim, në të cilat ju:

- (a) Vlerësoni rreziqet e biznesit që duhen marrë parasysh në planifikimin e auditimit të kompanisë. (8 pikë)
- (b) Vlerësoni rreziqet e anomalive materiale që duhet të merren parasysh në zhvillimin e strategjisë së auditimit dhe planit të auditimit. (18 pikë)
- (c) Hartoni procedurat kryesore të auditimit që do të përdoren në auditimin e grantit të marrë nga qeveria në shtator 2021. (6 pikë)

Shtojca 2 – Shënime nga takimi i mbajtur më 30 nëntor 2021

Të pranishëm në takim:

Vlora Kema, partnere e angazhimit të auditimit, HanSolo

Anita B, drejtore e financave, SportKos

Historiku i biznesit

SportKos operon 20 qendra sporti dhe argëtimi në të gjithë vendin. Çdo qendër ka një palestër të madhe dhe një pishinë, dhe shumë prej tyre kanë gjithashtu fusha tenisi. Duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve të kompanisë, ajo duhet të jetë në përputhje me rregulloret e shëndetit dhe sigurisë të vendosura nga organi rregullator kombëtar dhe objektet e saj inspektohen rregullisht

për të siguruar që të gjitha rregulloret janë duke u ndjekur dhe që kompania të ruajë licencën e saj të funksionimit.

Kompania nuk është e listuar dhe për këtë arsye nuk ka nevojë të jetë në përputhje me rregulloret e qeverisjes së korporatës. Megjithatë, drejtori operativ dhe kryetari i kompanisë e konsiderojnë praktikë të mirë që të ketë kontribut të pavarur në bord dhe ka dy drejtorë joekzekutivë. Një nga drejtorët joekzekutivë është një ekspert i industrisë në të cilën operon kompania, i cili ishte kryetar i një kompanie rivale, Shneta ShA, për dhjetë vjet. Drejtori i dytë joekzekutiv është një akademik i specializuar në sjelljen organizative dhe që ka shkruar disa libra mbi menaxhimin e performancës në industrinë e sportit dhe argëtimit.

Bordi i kompanisë ka miratuar një plan për t'u zgjeruar përmes blerjes së ofruesve të tjerë të objekteve të argëtimit dhe sportit. Strategjia nuk ka gjasa të zbatohet për dy vite të tjera, kur bordi do të donte që të ndodhte blerja e parë. Megjithatë, kompanitë potenciale të synuara do të identifikohen në 12 deri në 18 muajt e ardhshëm. Si qëllim përfundimtar, bordi do të donte të kërkonte listim të kompanisë në bursë brenda pesë viteve, dhe ata konsiderojnë se zgjerimi i kompanisë do të përmirësonte fitimet dhe do ta bënte një listim në bursë më të realizueshme.

SportKos ka një departament të vogël të auditimit të brendshëm me dy punonjës që raportojnë te drejtori i financave, pasi bordi nuk ka një komitet auditimi.

Kompania ofron një skemë anëtarësimi ku, për një abonim vjetor, anëtarët mund të përdorin objektet në çdo qendër. Klientët që nuk janë anëtarë mund të paguajnë për të hyrë në një qendër për një ditë sipas planit të kompanisë 'paguaj aty-për-aty'. Skema e anëtarësimit përbën përafërsisht 85% të të hyrave të kompanisë, të hyrat e mbetura rezultojnë nga shitjet 'paguaj aty-për-aty'.

Zhvillimet e fundit në kompani

Industria është konkurreuese dhe strategjia e kompanisë është të inkurajojë klientët të rinovojnë anëtarësimin e tyre dhe të tërheqin anëtarë të rinj duke ofruar një sërë aktivitete të reja. Sipas drejtorit financiar, një iniciativë e suksesshme e nisur në mars 2021 është fushata 'Fëmijët e Shëndetshëm'; kjo u ofron fëmijëve dy orë stërvitje në javë në një sërë sportesh duke përfshirë notin dhe tenis. Kjo stërvitje ofrohet falas si pjesë e anëtarësimit të prindërve të tyre dhe ka rezultuar shumë i suksesshëm - drejtori i financave vlerëson se ka çuar në 3000 anëtarë të rinj që nga fillimi i tij.

Në qershor 2021, kompania hapi një qendër të re sportive dhe argëtuese bregdetare, e cila, përveç objekteve të zakonshme, ka edhe një qendër zhytjeje dhe ofron ambiente të tjera sportive ujore. Një investim prej 12 milionë Euro u krye gjithashtu në pajisje të reja të palestrës në të gjitha qendrat, për të siguruar që kompania të ofrojë ambientet më moderne për klientët e saj.

Është nisur një fushatë reklamuese për të promovuar markën e kompanisë në përgjithësi dhe për të ndërgjegjësuar klientët për investimet në objektet që janë bërë. Si pjesë e kësaj fushate, kompania i pagoi 1 milion Euro një atleti të famshëm për të mbështetur kompaninë për një periudhë dyvjeçare. Atleti do të shfaqet në hapjen e qendrës së re sportive bregdetare dhe ka pranuar të shfaqet në reklama për dy vitet e ardhshme.

SportKos është gjithashtu i përfshirë me një iniciativë qeveritare për të ndihmuar të papunët të kenë qasje në objektet sportive.

Kompania mori një grant prej 2 milionë Euro në shtator 2021, sipas kushteve të të cilit u lejon të papunëve tre orë qasje falas në objektet e saj në muaj. Deri në fund të muajit nëntor, sipas kësaj skeme janë ofruar 33,900 orë pa pagesë të përdorimit të objektit. Qeveria synon që nisma të zgjasë për tre vjet, për të promovuar shëndetin afatgjatë të pjesëmarrësve.

Është prezantuar një sistem i ri i menaxhimit të të dhënave, i cili integron informacionin e anëtarësimit me softuerin e kontabilitetit. Kjo lejon një menaxhim më efikas të bazës së të dhënave të klientëve e cila përdoret gjerësisht për qëllime marketingu, si dhe ofrimin e informacionit më në kohë mbi performancën financiare për menaxhmentin. Të dhënat nga sistemi i mëparshëm u transferuan në sistemin e ri në korrik 2021, dhe të dy sistemet funksionuan paralelisht për dy muaj, ndërkohë që u bë trajnimi për stafin dhe monitorohej sistemi i ri. Një veçori e sistemit të ri është

se ai regjistron dhe raporton për orët e qasjes falas që u ofrohen të papunëve, të cilat kompania duhet t'i raportojë çdo muaj qeverisë.

Shtojca 3 – Ekstrakte nga pasqyrat menaxheriale të SportKos

	Shënimi	Parashikimi 28 shkurt 2022	Të audituara 28 shkurt 2021
Të hyra	1	53 milion	45 milion
Të hyra nga granti qeveritar	2	2 milion	-
Marzha operative	3	15%	10.7%
Fitimi para tatimit		6.9 milion	4.6 milion
Shpenzimet kapitale dhe huatë përkatëse	4	32 milion	20 milion
Paraja		1.4 milion	5.6 milion
Gjithsej pasuria		130 milion	110 milion
Numri i qendrave sportive	5	20	18
Numri i anëtarëve	6	38,000	33,800
Numri i biletave të shitura 'paguaj aty-për-aty'		108,000	102,600

Shënime

1. Të hyrat parashikohen të rriten ndjeshëm këtë vit. Kjo është kryesisht për shkak të suksesit të fushatës reklamuese që paraqet atletin e famshëm dhe programin 'Fëmijët e shëndetshëm' (referuar në Shtojcën 2).
2. Granti i marrë prej 2 milionë Euro, detajet e të cilit shpjegohen në Shtojcën 2, është njohur plotësisht si e ardhur për vitin.
3. Shpenzimet operative të kompanisë përfshijnë zërat e mëposhtëm:

	2022 Euro '000	2021 Euro '000
Paga	15,300	14,300
Marketing	8,500	8,500
Riparim dhe mirëmbajtje	5,500	5,300

4. Shpenzimi kapital kryesisht është financuar përmes krdisë. Me 1 mars 2021, ishte marrë një kredi prej 30 milion Euro për dhjetë vite. Kredia nuk ka interes dhe duhet të kthehet me vlerë nominale prej 34 milionë Euro. Përveç kredisë bankare, kompanisë iu dha një kredi prej 1 milion Euro nga drejtori i saj menaxhues, Betimi, më 1 korrik 2021. Kushtet e kësaj kredie përfshijnë 3% interes që i paguhet Betimit në fund të çdo viti dhe kryegjëja do të shlyhet pas shtatë vitesh në 2026.
5. Dy qendra të reja sportive dhe argëtuese u hapën këtë vit. Si dhe qendra bregdetare e sportit dhe e argëtimit (referuar në Shtojcën 2), një qendër e re u hap në një zonë urbane të pasur në kryeqytet.
6. Sistemi i informacionit të menaxhimit tregon se anëtarët vizitojnë një qendër sportive dhe argëtimi mesatarisht tre herë në javë.

Zgjidhja

Shënime informuese

Për: Vlora Kema, partnere e angazhimit të auditimit

Nga: Menaxheri i auditimit

Tema: Auditimi i SportKos

Hyrje

Pjesa e parë e këtyre shënimeve informuese është përgatitur në lidhje me auditimin e SportKos. Planifikimi i auditimit do të fillojë së shpejti dhe këto shënime vlerësojnë rreziqet e biznesit dhe rreziqet e anomalive materiale që duhen marrë parasysh në planifikimin e auditimit. Shënimet më pas vazhdojnë të rekomandojnë procedurat kryesore të auditimit që do të përdoren në auditimin e një granti qeveritar që kompania mori gjatë vitit.

(a) Vlerësimi i rreziqeve të biznesit që duhet të merren parasysh në planifikimin e auditimit të SportKos

Qeverisja e korporatave

Kompania nuk obligohet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e qeverisjes së korporatës pasi nuk është një entitet i listuar dhe është mirë të theksohet se bordi përfshin dy drejtorë joekzekutivë, të cilët duket se janë në gjendje të ofrojnë pikëpamje të pavarura mbi strategjinë dhe menaxhimin.

Megjithatë, kompanisë i mungon një komitet auditimi dhe ekipi i auditimit të brendshëm është i vogël dhe i mungon pavarësia pasi ata i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit të financave. Kjo do të thotë se fushëveprimi i punës së tyre ka gjasë të jetë mjaft i kufizuar për shkak të burimeve të pamjaftueshme dhe çdo rekomandim i bërë mund të injorohet nga drejtori financiar. Në përgjithësi, kjo mund të çojë në mangësi në kontrole dhe joefikasitet në operacionet e biznesit. Për më tepër, duke qenë se kompania po kërkon të listohet në bursë në vitet e ardhshme, do të ishte praktikë e mirë që të zbatoheshin procedura më të forta qeverisjeje më shpejt se sa vonë. Për shembull, të kesh dy drejtorë joekzekutivë mund të mos mjaftojë për të përmbushur kërkesat e qeverisjes së korporatës në juridiksionin e kompanisë.

Rregulloret e shëndetit dhe sigurisë

Kompania operon në një industri shumë të rregulluar dhe rreziku i mosrespektimit të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme është i lartë.

Industria e sportit dhe e argëtimit ka rregulla strikte të shëndetit dhe sigurisë, të cilat duhet të respektohen, dhe ka inspektime të rregullta të shëndetit dhe sigurisë për të siguruar që rregullat po respektohen. Nëse kompania konstatohet se nuk është në përputhje me rregulloret përkatëse, licenca e saj e operimit mund t'i hiqet, gjë që do të kishte pasoja në reputacion dhe në fund mund të ndikojë në statusin e vijimësisë së kompanisë. Përveç rrezikut të mospajtueshmërisë me ligje, do të jetë e kushtueshme zvogëlimi i këtij rreziku në një nivel të pranueshëm, për shembull, përmes trajnimit të rregullt të stafit për shëndetin dhe sigurinë, duke çuar në probleme me rrjedhën e parasë dhe fitimin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet sportive më aventurëske si zhytja, të cilat kompania ka filluar të ofrojë kohët e fundit.

Kërkesat për shpenzime kapitale dhe mirëmbajtje

Suksesi i kompanisë mbështetet në pajisjen e palestrave me pajisje moderne, si dhe të ambienteve të tjera si fusha tenisi që mirëmbahen në një standard të lartë. Kjo kërkon një shpenzim të lartë vjetor, për shembull, vetëm këtë vit janë bërë 5.5 milionë euro për mirëmbajtje dhe riparime. Shpenzime të tilla të larta vjetore janë një rrjedhje e madhe e parave të gatshme dhe kompania mund të përballlet me probleme likuiditeti nëse nuk mbahen flukset e parave hyrëse nga klientët.

Likuiditeti dhe mbitregtimi

Pozicioni i parave të gatshme të kompanisë parashikohet të përkeqësohet ndjeshëm, me rënien e nivelit të parave nga 5.6 milion euro në 1.4 milion euro në vit. Në të njëjtën kohë, të ardhurat dhe fitimi para tatimit parashikohen të rriten, përkatësisht me 17.8% dhe 50%. Ndërsa ka disa dyshime mbi integritetin e shifrave të raportuara nga menaxhmenti, të cilat do të diskutohen në seksionin tjetër të shënimeve informuese, tendencat mund të tregojnë se kompania po zgjerohet shumë shpejt dhe po mbitregon, duke u fokusuar në gjenerimin e të ardhurave dhe jo në menaxhimin

rrjedhës së parasë në mënyrë të përshtatshme. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh planet e kompanisë për zgjerim të mëtejshëm në vitet e ardhshme.

Kapaciteti

Mund të ketë probleme me të cilat përballet kompania për sa i përket kapacitetit të objekteve të saj. Anëtarësia është rritur ndjeshëm gjatë vitit, me 12.4%, dhe numri i vizitave 'paguaj aty-për-aty' është rritur me 5.3%. Edhe pse këtë vit janë hapur dy qendra të reja sportive dhe argëtimi, ky mund të mos jetë zgjerim i mjaftueshëm dhe mund të ketë raste kur ambientet janë të mbipopulluara. Kjo mund t'i pengojë anëtarët të rinovojnë anëtarësimin e tyre dhe klientët mund të preferojnë të përdorin ofrues të tjerë sporti dhe argëtimi nëse mbipopullimi bëhet problematik. Programi 'Fëmijët e shëndoshë' dhe iniciativa e qeverisë për të ofruar qasje falas për të papunët do ta përkeqësojnë këtë problem.

Shpenzimet e konkurrencës dhe marketingut

Industria është konkurruese, që në vetvete është një rrezik biznesi, që do të thotë se ka presion mbi kompaninë për të ruajtur pjesën e saj të tregut dhe bazën e klientëve. Mund të ketë presion për të ulur anëtarësimin ose për të paguar tarifën, gjë që do të ndikojë në marzhat e fitimit dhe rrjedhën e parave. Kompania duket se shpenzon shumë në marketing për të mbështetur markën e saj. Këtë vit, 8.5 milionë euro janë shpenzuar për marketing, që është e barabartë me 16% të të ardhurave. Kjo është një dalje e madhe në para dhe do të ndikojë ndjeshëm në pozicionin e likuiditetit të kompanisë.

Nisma e qeverisë

Ndërsa përfshirja e kompanisë në iniciativën e qeverisë për të promovuar një mënyrë jetese të shëndetshme për njerëzit e papunë është e lavdërueshme, ajo mund të mos jetë e popullarizuar me anëtarët ekzistues të qendrës sportive dhe të argëtimit dhe për klientët 'paguaj-aty-për-aty'. Nisma do të ushtrojë presion mbi kapacitetin e palestrave dhe mund të çojë në mbushjen e ambienteve, veçanërisht në kohën e pikut. Kjo mund të çojë që anëtarësimet të mos rinovohen dhe ikjen e klientëve 'paguaj-aty-për-aty' të ofruesit të tjerë. Ekziston gjithashtu një çështje e koston oportune për kompaninë, pasi marrja e grantit prej 2 milionë eurosh nuk duket të jetë veçanërisht fitimprurëse për sa i përket numrit të orëve të qasjes falas në palestrat që duhet të sigurohen për tre vitet e ardhshme.

Ekziston një rrezik shoqëruar në atë që sistemet e kompanisë duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë me saktësi numrin e orëve të lira që ofrohen nga kjo nismë, pasi kjo duhet të raportohet në baza mujore. Rreziku është që sistemet të mos kapin me saktësi informacionin e nevojshëm, gjë që mund të çojë në raportimin e informacionit të rremë në qeveri. Ka të dhëna se ky sistem regjistrimi mund të mbivlerësojë orët e qasjes së lirë, pasi sipas drejtorit financiar, tashmë janë siguruar 33,900 orë pa pagesë, që në periudhën tre mujore që nga fillimi i nismës në shtator 2021 barazohet me 11,300 orë në muaj, që duket e lartë pasi kjo nënkupton se rreth 3,800 persona i janë përgjigjur nismës.

Planet e zgjerimit

Planet e zgjerimit mund të largojnë vëmendjen e menaxhmentit nga drejtimi i biznesit, veçanërisht nëse identifikimi i kompanive potenciale të synuara bëhet një proces që kërkon kohë gjatë vitit të ardhshëm. Kontrollat e menaxhmentit mbi operacionet ekzistuese mund të përkeqësohen, ndërkohë që vëmendja përqendrohet në zgjerimin e planifikuar dhe listimin e mundshëm në të ardhmen. Nëse ka presion nga aksionarët ekzistues që zgjerimi të jetë i suksesshëm dhe të ndodhë listimi, menaxhmenti mund të jetë nën presion për të marrë vendime jo të mençura për të rritur ritmin e zhvillimit të aktiviteteve të kompanisë.

Sistemi i ri i menaxhimit të të dhënave

Futja e një sistemi të ri të menaxhimit të të dhënave mund të krijojë një rrezik biznesi në atë që mund të jetë ofruar trajnim i pamjaftueshëm dhe/ose kontrole të brendshme të duhura mund të mos jenë hartuar ose zbatuar në lidhje me sistemin e ri, duke rritur rrezikun e regjistrimit, përpunimit dhe raportimit të pasaktë të informacionit. Kjo do të kishte një ndikim negativ në aftësinë e menaxhmentit për të monitoruar performancën e kompanisë. Duke qenë se sistemi i ri është i lidhur me softuerin e kontabilitetit të kompanisë, ekziston një rrezik auditimi i lidhur, i cili do të diskutohet në seksionin vijues të këtyre shënimeve informuese.

(b) Vlerësimi i rrezikut të anomalive materiale

Njëanshmëria e menaxhmentit

Kompania ka plane ambicioze zgjerimi dhe synon të arrijë një listim në bursë brenda pesë viteve. Kjo mund të krijojë presion të konsiderueshëm mbi menaxhmentin për të raportuar performancë të fortë financiare dhe rreziku i menaxhimit të fitimeve është i lartë.

Kjo mund të çojë në një sërë trajtimesh kontabël të papërshtatshme duke përfshirë njohjen e hershme të të ardhurave dhe të ardhurave të tjera dhe shtyrjen e shpenzimeve. Ka disa indikacione se menaxhimi i fitimeve mund të jetë bërë këtë vit, për shembull, të ardhurat parashikohen të rriten me 17.8%, ndërsa numri i anëtarëve, të cilët sigurojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të kompanisë, është rritur vetëm me 12.4. %. Fitimi para tatimit parashikohet të rritet me 50%. Këto tendenca tregojnë se të ardhurat mund të mbivlerësohen dhe shpenzimet të nënvlerësohen, arsye specifike për të cilat vlerësohen më poshtë.

Qeverisja e korporatave dhe kontrollat e brendshme

Siç u diskutua në seksionin e mëparshëm, kompanisë i mungon një komitet auditimi dhe ka vetëm një ekip të vogël të auditimit të brendshëm i cili nuk funksionon në mënyrë të pavarur. Kjo ka implikime për kontrollat mbi raportimin financiar, të cilat mund të jenë të mangëta dhe rrit rrezikun e kontrollit. Ka një hapësirë të madhe për gabime në proceset e raportimit financiar dhe për manipulime të qëllimshme të saldoeve dhe transaksioneve, pasi ekipi i auditimit të brendshëm nuk ka burime të mjaftueshme për monitorim dhe raportim të plotë.

Njohja e të ardhurave

Me 85% të të ardhurave nga abonimet e anëtarëve, ekziston rreziku që të ardhurat të njihen gabimisht. Ekziston rreziku që koha e njohjes së të ardhurave të mos jetë e përshtatshme, për shembull, nëse një anëtarësim vjetor njihet plotësisht kur merret nga kompania, në vend që të njihet gjatë periudhës së anëtarësimit, duke mbivlerësuar kështu të ardhurat.

Ekzistojnë rrjedha të shumta të të ardhurave që e ndërlikojnë procesin e raportimit financiar dhe rrisin rrezikun. Si dhe anëtarët që paguajnë një abonim vjetor, klientët mund të paguajnë për qasjen në skemën e pagesës aty-për-aty. Për më tepër, qasja e lirë për të papunët nuk duhet të rezultojë në njohjen e të ardhurave, por duhet të regjistrohet siç duhet pasi duhet t'i raportohet qeverisë në baza mujore. Siç u diskutua më lart, është e mundur që sistemi të mos regjistrojë me saktësi qasjen falas të ofruar për të papunët dhe që shifrat mund të mbivlerësohen.

Shpenzimet kapitale dhe shpenzimet e mirëmbajtjes

Kompania ka nivele të larta si të shpenzimeve kapitale ashtu edhe të kostove të mirëmbajtjes. Ekziston rreziku i anomalive materiale që shpenzimet kapitale dhe shpenzimet operative nuk janë ndarë siç duhet për qëllime kontabël. Për shembull, kostot e mirëmbajtjes mund të kapitalizohen gabimisht në pasuri, duke mbivlerësuar pasuritë dhe duke nënvlerësuar shpenzimet operative. Kjo mund të tregohet nga kostot e mirëmbajtjes që përfaqësojnë 10.4% të të ardhurave këtë vit, krahasuar me 11.7% një vit më parë. Shpenzimet kapitale janë regjistruar në 32 milionë euro këtë vit krahasuar me 20 milionë euro një vit më parë; Kjo rritje e ndjeshme mund të shpjegohet të paktën pjesërisht nga hapja e dy qendrave të reja gjatë vitit, por puna e auditimit do të duhet të fokusohet në mbivlerësimin e mundshëm të shpenzimeve kapitale.

Granti qeveritar

Kompania ka marrë një grant prej 2 milionë eurosh këtë vit, i cili është njohur si të ardhura të tjera operative. Shuma është materiale, që përfaqëson 29% të fitimit të parashikuar para tatimit. Rreziku i anomalive materiale lidhet me faktin nëse e gjithë kjo duhet të ishte njohur si e ardhur në periudhën aktuale kontabël. SNK @ 20 *Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shpalosja e Ndihmës së Qeverisë* kërkon që grantet qeveritare të njihen në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike gjatë periudhave në të cilat entiteti njih shpenzimet për kostot përkatëse për të cilat grantet synohen të kompensojnë. SportKos ka njohur të gjitha të ardhurat këtë vit, megjithatë, skema synohet të funksionojë për tre vjet. Prandaj, ekziston rreziku që kompania t'i ketë njohur të ardhurat shumë herët dhe një pjesë e tyre të mbetet si e ardhur e shtyrë; kjo çon në fitim të mbivlerësuar dhe në detyrime të nënvlerësuar.

Mund të ketë një çështje tjetër në atë që kushtet e grantit mund të kërkojnë ripagim të plotë ose të pjesshëm nëse nuk plotësohet numri i kërkuar i orëve të qasjes falas në objektet sportive. Nëse

ekzistojnë kushte të tilla, kompania duhet të vlerësojë nëse kushtet ka gjasë të përmbushen, dhe nëse jo, duhet të konsiderojë nëse do të ishte e përshtatshme të njihej një provizion ose të shpaloste një detyrim kontingjent në shënimet e pasqyrave financiare. Prandaj, rreziku është që ky të mos jetë marrë parasysh nga menaxhmenti, duke çuar ndoshta në detyrime të nënvlerësuara ose në shpalosje joadekuate siç kërkohet nga SNK 37 *Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente*.

Sistemi i menaxhimit të të dhënave

Futja e sistemeve të reja, veçanërisht ato që ndërlihen me sistemin e kontabilitetit, krijon një rrezik për anomali materiale. Mund të jenë bërë gabime në transferimin e të dhënave nga sistemi i vjetër në sistemin e ri, dhe pasi ky sistem merret me informacionin e anëtarësimit, ka gjasë të ndikojë në mënyrën se si regjistrohen dhe përpunohen të ardhurat. Jo i gjithë personeli mund të jetë trajnuar ende për funksionimin e sistemit, duke çuar në një rrezik më të lartë gabimi dhe kontrollat mund të mos jenë zbatuar ende plotësisht. E gjithë kjo do të thotë se transaksionet dhe bilancet në lidhje me anëtarët janë në rrezik të keqdeklarimit.

Tarifa e paguar për atletin e famshëm

1 milion euro të paguar për atletin e famshëm është material, që përfaqëson 14.4% të fitimit neto të parashikuar për vitin. Duke qenë se atleti po ofron një shërbim për kompaninë për dy vjet, kostoja duhet të njihet gjatë asaj periudhe dyvjeçare, me një element të koston të shtyrë. Nëse i gjithë shpenzimi është njohur këtë vit, fitimi nënvlerësohet dhe pasuritë nënvlerësohen.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative përfshijnë kostot e personelit, të cilat parashikohen të rriten me 7%, kostot e marketingut, të cilat parashikohen të qëndrojnë në të njëjtën masë në krahasim me 20X8, dhe kostot e mirëmbajtjes dhe riparimit që janë rritur me 3.8%. Duke pasur parasysh rritjen e të ardhurave prej 17.8%, dhe rritjen e shkallës së operacioneve me hapjen e dy qendrave të reja, këto kategori shpenzimesh pritet të rriten me një shumë më të madhe këtë vit. Mund të ndodhë që shpenzimet të jenë lënë anash gabimisht, ose të jenë përjashtuar qëllimisht, duke nënvlerësuar kështu shpenzimet dhe duke mbivlerësuar fitimin. Këto tendenca duhet të diskutohen me menaxhmentin, veçanërisht kostot e stafit, pasi vetëm kjo është shumë materiale, që përfaqëson 28.9% të të ardhurave të parashikuara.

Kredia bankare

Gjatë vitit, kompania mori një hua të konsiderueshme prej 30 milionë eurosh; kjo është materiale pasi përfaqëson 23.1% të totalit të pasurive.

Huaja është lëshuar me një zbritje të madhe dhe ekziston rreziku i anomalive materiale në atë që kostot financiare që lidhen me këtë kredi mund të mos llogariten në përputhje me SNRF 9 Instrumentet *Financiare*. SNRF 9 kërkon që kostoja financiare e lidhur me një zbritje të madhe – në këtë rast diferenca prej 4 milionë eurosh midis shumës së marrë nga SportKos prej 30 milionë eurosh dhe shumës së ripagueshme në maturim të borxhit prej 34 milionë eurosh – duhet të amortizohet mbi afatin e kredisë. Rreziku është që kostot financiare dhe detyrimet afatgjata do të nënvlerësohen nëse kostoja e duhur financiare nuk është përlllogaritur në këtë vit financiar.

Transaksioni me palët e lidhura

Drejtori menaxhues i SportKos, Betimi, i ka dhënë kompanisë një hua prej 1 milion eurosh. Ndonëse kjo nuk është materiale në terma monetarë, duke përfaqësuar vetëm 0.8% të totalit të pasurive, është materiale për nga natyra dhe është një transaksion me palët e lidhura sipas SNK 24 *Shpalosjet e Palëve të Lidhura* duke pasur parasysh se kredia për kompaninë është nga një anëtar i personeli menaxhues. Duhet të bëhen shpalosje përkatëse siç kërkohet nga SNK 24 në shënimet e pasqyrave financiare dhe ekziston rreziku që shpalosjet të jenë jo të plota. Shpalosjet e nevojshme përfshijnë informacion mbi natyrën e transaksionit me palët e lidhura, shumën e tij dhe kushtet përkatëse të huasë.

Ekziston gjithashtu rreziku që interesi për kredinë të mos paraqitet si një aktual. Huaja është dhënë më 1 korrik 2021, kështu që deri në fund të vitit duhet të regjistrohet një shpenzim akuak interesi prej 20,000 euro (1 milion euro x 3% x 8/12). Kjo nuk është materiale në terma monetarë për pasqyrat financiare pasi përfaqëson më pak se 1% të fitimit të parashikuar para tatimit, megjithatë,

grykimi i auditimit mund të konkludojë se është material duke pasur parasysh natyrën e transaksionit nga palët e lidhura.

(c) Procedurat kryesore të auditimit që do të përdoren për grantin qeveritar

- Merrni dokumentacionin në lidhje me grantin, për të konfirmuar shumën, datën e transferimit të parave të gatshme në kompani, periudhën e mbuluar nga granti dhe kushtet në të cilat është dhënë granti.

- Rishikoni kushtet për të konfirmuar nëse ato përmbajnë ndonjë kusht në lidhje me ripagimin e mundshëm të një pjese ose të të gjithë grantit nëse një numër i kërkuar i orëve të qasjes falas nuk plotësohet në periudhën e mbuluar nga granti.

- Rakordoni shumën e parave të gatshme të marra në pasqyrën bankare dhe librin e parave të gatshme.

- Kryen teste kontrolli në sistemin e përdorur për të regjistruar numrin e orëve të qasjes së lirë që janë përdorur nga të papunët, duke u fokusuar në mënyrën se si regjistrohet qasja, për t'u siguruar që regjistrimi është i plotë dhe i saktë dhe se të ardhurat nuk janë regjistruar/njohur.

- Rishikoni parashikimet dhe buxhetet për të vlerësuar modelin e përdorimit të parashikuar të iniciativës nga të papunët dhe për të konfirmuar se ripagimi i grantit nuk ka gjasa.

- Diskutoni me menaxhmentin politikën kontabël të përdorur për arkëtimin e parasë, për të konfirmuar të kuptuarit se të gjitha janë njohur plotësisht këtë vit dhe për të kuptuar arsyetimin e menaxhmentit për këtë trajtim kontabël.

- Rillogaritni shumën që duhet të ishte njohur në bazë të njohjes së grantit për periudhën trevjeçare të nismës së qeverisë.

Detyra 2

Më poshtë janë përshkruar situatat që janë paraqitur te pesë klientët e auditimit të firmës tuaj. Fundi i vitit në secilin rast është 30 qershor 2022. Situatat nuk janë të lidhura me njëra tjetrën.

Kabllari ShPK

Kabllari ndërton dhe operon rrjete me fibra optike. Gjatë vitit, kompania ka kapitalizuar gabimisht kostot prej 6.1 milion € në lidhje me riparimet dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të saj dhe i ka përfshirë këto kosto në pasuritë joqarkulluese. Drejtorët refuzojnë të bëjnë ndonjë rregullim në lidhje me këtë çështje pasi një rregullim i tillë do të bënte që kompania të shkelte një marrëveshje kredie. Pasuritë totale të Kabllari më 30 qershor 2022 janë 1,050 milionë euro dhe fitimi para tatimit për vitin e përfunduar atëherë është 142.6 milionë euro.

Fieri SHA

Fieri mban regjistrime të vazhdueshme të stoqeve dhe për pasojë kompania nuk kryen një numërim fizik në fund të vitit. Më 5 korrik 2022, një zjarr në zyrën e depos së Fierit shkatërroi të dhënat e stoqeve dhe të dhënat e fletdërgesave të kompanisë. Stoqet fizike nuk janë dëmtuar. Nuk kishte procedura alternative të kënaqshme të auditimit që mund të kryheshin. Kompania ka përfshirë një shifër të vlerësuar të stoqeve përmbyllëse prej €500,000 në pasqyrat financiare. Ky vlerësim përfaqëson 5% të totalit të pasurive të Fierit dhe 20% të fitimit para tatimit.

Medlina SHA

Medlina operon me mbështetjen e vazhdueshme të bankës së saj për të financuar operacionet e saj. Kredia aktuale skadon më 31 dhjetor 2022 dhe megjithëse drejtorët presin të jenë në gjendje të rinovojnë kredinë me kushte të ngjashme, ata nuk kanë asnjë marrëveshje detyruese me bankën. Drejtorët kanë përgatitur parashikime të rrjedhës së parasë bazuar në supozimin se kredia do të rinovohet. Këto parashikime tregojnë se kompania do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Drejtorët kanë rënë dakord të përfshijnë një shënim në pasqyrat financiare që shpalos plotësisht situatën. Raporti i auditimit duhet të nënshkruhet më 30 shtator 2022.

Hasani ShPK

Hasani ShPK zotëron një pikturë të një artisti pak të njohur, Lugati, e cila kushtoi 12,000 dollarë amerikan kur u ble në 1984. Pas raportimeve të lajmeve se një pikturë tjetër nga i njëjti artist sapo është shitur në një ankand prestigjioz arti për 1,000,000 €, drejtorët kanë rritur vlerën e pikturës ekzistuese në 1,015,240 € (d.m.th. kosto plus 1,000,000 €) pas një vlerësimi nga një firmë me reputacion ekspertësh të artit. Teprica mbi koston është regjistruar në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nën titullin "Të ardhura të tjera operative". Sasia e rregullimit tejkalon lehtësisht materialitetin e angazhimit për entitetin.

Simtech ShA

Simtech ShA është një kompani e listuar e cila prodhon pajisje shumë të sofistikuar për forcat e armatosura. Pasqyrat financiare do të nënshkruhen më 6 shtator 2022. Gjatë rrjedhës së auditimit tuaj ju jeni informuar se qeveria ka shumë gjasa të heqë dorë nga një përmirësim i planifikuar i pajisjeve të forcave të armatosura për shkak të kufizimeve buxhetore. Jeni të vetëdijshëm se parashikimet e klientit tuaj mbështeten shumë në një kontratë të madhe me Ministrinë e Mbrojtjes për të përmirësuar pajisjet e forcave të armatosura.

Kompania tashmë po përjeton vështirësi në rrjedhën e parasë dhe së fundmi ka aplikuar për një rritje të ndjeshme të mbitërheqjes bankare të saj që tashmë është tërhequr plotësisht. Menaxhmenti është i bindur se kompania do të vazhdojë të jetë e qëndrueshme. Nëse është e nevojshme, ajo pretendon se mund të përdorë shkurtime në programin e saj të ardhshëm të shpenzimeve kapitale, të kërkojë financime shtesë jashtë bilancit dhe/ose të riprogramojë marrëveshjet ekzistuese të borxhit. Ju jeni shumë skeptik ndaj këtyre pretendimeve.

Kërkohe:

(a) Vlerësoni në mënyrë kritike ndikimin e sjelljes së drejtorëve të Kabllari në vendimin e firmës suaj nëse do të vazhdojë apo jo të veprojë si auditor i jashtëm për vitin që përfundon më 30 qershor 2022. (5 pikë)

(b) Në secilën nga pesë situatat e përshkruara më sipër, deklaroni nëse raporti i auditimit duhet të modifikohet. Arsyetoni konkluzionet tuaja dhe përshkruani modifikimet, nëse ka, në çdo raport auditimi. (20 pikë)

(Gjithsej: 25 pikë)

Zgjidhja

a)

Drejtorët e Kabllari duket se janë të përfshirë në një ushtrim të menaxhimit agresiv të fitimeve, nëse jo falsifikimin aktual të pasqyrave financiare. Ata po përpiqen të mos i shkelin marrëveshjet e huasë dhe kështu kanë kapitalizuar gabimisht riparimet dhe mirëmbajtjen në shumën prej 6.1 milionë euro. Shuma e përfshirë është vetëm 4.28% e fitimit para tatimit dhe 0.58% e totalit të pasurive. Këto shuma normalisht do të konsideroheshin si jomateriale, por rrethanat në këtë skenar, domethënë fakti që kjo shumë bën dallimin midis shkeljes së një marrëveshjeje kredie dhe respektimit të tij, e bën rregullimin material. Dështimi i drejtorëve për të pranuar kërkesën tonë për të ndryshuar pasqyrat financiare do të thotë se ne do të duhet të shqyrtojmë me kujdes nëse mund të vazhdojmë si auditorë në vitet e ardhshme (duke supozuar se na jepet mundësia për ta bërë këtë!).

Ky incident e bën nivelin e rrezikut të vetvetëshëm për këtë klient më të lartë se sa është vlerësuar më parë pasi vë në pikëpyetje sjelljen (dhe ndoshta edhe integritetin) e drejtorëve. Fakti që kompania ka shkelur në të vërtetë një marrëveshje kredie do të thotë se ajo mund të jetë financiarisht e pasigurt dhe mund të kenë problem me vijimësinë. Kjo mund t'i tundojë drejtorët që të bëjnë diçka të ngjashme në vitet e ardhshme. Rrit rrezikun e auditimit akoma më shumë.

Ne nuk e dimë saktësisht se si kostot u kapitalizuan gabimisht në radhë të parë, por ose ishte një vendim i drejtorëve (me implikime të natyrshme të rrezikut siç përshkruhet më lart) ose ai erdhi nga një dështim në sistemin e kontrollit të brendshëm të kompanisë në të cilin rast ka implikime për vlerësimin e rrezikut të kontrollit.

Nga këndvështrimi ynë, ne tani duhet të vendosim nëse rreziku i auditimit tani është shumë i lartë për ne që të vazhdojmë të auditojmë këtë klient. Nëse vendosim të ndërpresim punën si auditorë, do të duhet të bëjmë një deklaratë për të shpjeguar arsyet e dorëheqjes sonë. Kjo deklaratë duhet të hartohet me kujdes.

Kabllari ShPK

Refuzimi i drejtorëve për të ndryshuar pasqyrat financiare do të thotë se Kabllari do të ketë një raport auditimi të kualifikuar "përveç" mosmarrëveshjeve. Kjo do të specifikojë sasinë e mosmarrëveshjes. Gjithashtu mund t'i shtyjë auditorët të marrin në konsideratë nevojën për

vendosjen e një paragrafi shtesë 'Pasiguria materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë' për të shpjeguar çështjen.

Fieri SHA

Me 5% të totalit të pasurive dhe 20% të fitimit para tatimit, shumta e stokeve është materiale, por jo e përhapur në pasqyrën financiare. Çështja në fjalë është një "pamjaftueshmëri e dëshmive të auditimit" (nganjëherë referuar si kufizim i fushëveprimit) të auditimit që lind si rezultat i rrethanave të paparashikuara. Prandaj, do të duket se kualifikimi i raportit të auditimit "përveç" "kufizimi i fushëveprimit" është i përshtatshëm. Kjo mund të ketë një implikim më të gjerë, sepse fletëdërgesat u shkatërruan gjithashtu dhe kjo mund të rrisë vështirësinë e përfundimit të dëshmive të auditimit mbi shitjet dhe të arkëtueshmet.

Medlina SHA

Në rast se raporti i duhur i auditimit do të ishte përfshirja e paragrafit të 'pasigurisë materialer lidhur me hipotezën e vijimësisë'. Kjo është kështu sepse

(i) Ndërkohë që ka dyshime për vijimësinë, ne si auditorë jemi të kënaqur që entiteti do të vijojë operacionin sipas kësaj hipoteze dhe ne kemi arritur në këtë përfundim pasi kemi ekzaminuar parashikimin e rrjedhës së parasë, supozimet e bëra; pra planin e menaxhmentit për tejkalimin e vështirësive financiare. Kjo po ashtu do të thotë se ne kemi pranuar planin e menaxhmentit i cili mbulon një periudhë së paku dymbëdhjet-mujore pas përfundimit të vitit.

(ii) Një shënim është përfshirë në pasqyrat financiare duke shpjeguar plotësisht situatën.

Hasani ShPK

Nuk ka asnjë justifikim që Hasani të rrisë vlerën e pikturës në këtë mënyrë dhe sigurisht jo për përfshirjen e rritjes në "Të ardhura të tjera operative". Ky nuk është fitim i realizuar dhe nuk mund të përfshihet në rezervat që mund të shpërndahen. Na thuhet se shumta e tejkalon lehtësisht materialitetin dhe kështu, të paktën, na duhet një opinion i kualifikuar "përveç" që specifikon shumën. Nëse mendojmë se shumta e përfshirë është thelbësore për pasqyrën financiare, mund të jetë e nevojshme të shprehim një opinion të kundërt.

Simtech ShA

Vështirësia këtu është se si auditorë ne kemi vendosur që kjo kompani të mos jetë më një aktivitet në vijimësi. Megjithatë, drejtorët insistojnë në përgatitjen e pasqyrave financiare mbi bazën e vijimësisë. Prandaj, ne nuk kemi zgjidhje tjetër veçse të japim një raport auditimi me një opinion të kundërt, pra të themi se pasqyrat financiare nuk tregojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë.

Detyra 3

(a) SNA 706 (E rishikuar), *Paragrafët e theksimit të çështjes dhe paragrafët e çështjes tjetër në një raport të auditorit të pavarur* ofron udhëzime për përdorimin e këtyre paragrafëve nga auditorët.

Kërkohet:

(i) Përkufizoni një 'Paragraf të theksimit të çështjes' dhe shpjegoni me shembuj përdorimin e këtij paragrafi. (4 pikë)

(b) Stili është emri tregtar i Koko ShA. Stili është një dyqan i pavarur i vendosur në qendër të një qyteti të madh. Ajo shet piktura të shtrenjta, origjinale dhe vepra të tjera arti si skulptura të vogla. Ju jeni partner i angazhimit në firmën EveryAudit.. Firma juaj po ndërmerr auditimin për herë të parë të këtij klienti.

Klientët e Stili janë individë të pasur (ose, herë pas here, korporata) të cilët janë të përgatitur të shpenzojnë shuma të konsiderueshme parash për vepra arti. Artikulli më i lirë në dyqan shitet për mijëra euro.

Shitjet më të shtrenjta të Stili janë të gjitha artikujt që porositen posaçërisht nga klientët. Dyqani merr në dorëzim artikuj të tillë dhe i mban në një kasafortë të sigurt në bodrumin e dyqanit. Gjithashtu mban një numër të konsiderueshëm veprash arti të formave të ndryshme. Në përgjithësi shfaq kopje në vetë dyqanin, por klientët e "interesuar" herë pas here ftohen të shohin origjinalet në kasaforta.

Kompania mban të dhëna shumë të detajuara për çdo artikull të blerë. Kur Stili blen një vepër arti, duhet shumë kujdes që të sigurohet që shitësi të jetë legjitim dhe i besueshëm. Ky është shpesh artisti origjinal, por gjithashtu blen vepra në ankande arti dhe përmes burimeve të tjera tregtare. Me kalimin e viteve, menaxhmenti ka krijuar përvojë të konsiderueshme në këtë drejtim. Pikturat ose veprat e tjera të artit testohen shumë mirë, sepse vlera varet nga artisti, nga mosha dhe gjendja e veprës dhe nga siguria e origjinës së saj. Stili punëson ekspertët kryesorë të vendit për të ekzaminuar dhe shkruar raporte që verifikojnë vërtetësinë e veprave të mbajtura dhe këto raporte janë të disponueshme dhe të rëndësishme për blerësit e mundshëm. Stili ka një statistikë të pasqyruar ekselence në verifikimin e origjinalitetit të artikujve që shet.

Ashtu si të gjitha kompanitë e tjera në këtë industri, ka një rritje shumë të madhe në shitjet e Stili. Në mënyrë tipike, çmimet e shitjes janë trefishi i kostos origjinale të veprave të artit.

Si partner auditimi, ju keni vendosur që auditimi i stoqeve të Stili do të kërkojë ndihmën e një eksperti të pavarur në vlerësimet e artit. Një takim fillestar u zhvillua me një ekspert të tillë, i cili jo domosdoshmërisht do të zgjidhet për të ndihmuar në auditimin e Stili. Ekspertja tha se ajo do të kërkonte udhëzime të hollësishme për rolin e saj në auditim për arsyt e mëposhtme:

- Ajo do të ketë nevojë për udhëzime specifike se sa të detajuara duhet të bëjë një ekzaminim. Nëse ajo inspekton, për shembull, një pikturë ose skulpturë vizualisht, atëherë ajo mund të konfirmojë se është e vërtetë dhe mund të bëjë disa kontrolle bazike duke përdorur pajisje portative. Megjithatë, ajo nuk mund të konfirmojë informacionin e detajuar të mbledhur nga Stili pa e çuar secilën vepër në punëtorinë e saj për një ekzaminim të plotë. Një ekzaminim i tillë do të kërkonte shumë kohë dhe do të kushtonte shumë.
- Ajo duhet të dijë se si do të përdoret raporti i saj për ju. Ajo nuk dëshiron të mbahet përgjegjëse për ndonjë mosmarrëveshje mbi pasqyrat financiare të Stili.

Kërkohet:

(i) Vlerësoni hapat që do të duhet të ndërmerren në lidhje me përzgjedhjen e një eksperti të përshtatshëm të pavarur për të këshilluar mbi auditimin e stoqeve të Stili. (5 pikë)

(ii) Vlerësoni në mënyrë kritike faktorët që duhet të merren parasysh kur vendoset se sa i plotë duhet të jetë ekzaminimi i stoqeve të Stili nga eksperti. (6 pikë)

(iii) Diskutoni faktorët që duhen marrë parasysh për të siguruar efektivitetin e ekspertit të pavarur kur formoni një opinion auditimi mbi stoqet e Stili. (5 pikë)

(Gjithsej: 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Paragrafi i theksimit të çështjet është paragraf i cili përfshihet në raportin e auditorit dhe që referohet një çështjeje që është shpalosur si duhet në PF, që sipas gjykimit të auditorit është me aq rëndësi sa është fundamentale për shfrytëzuesit të kuptojnë PF.

SNA 706 Paragrafi i theksimit të çështjes dhe paragrafet e çështjeve tjera, tregon se paragrafi duhet të përdoret vetëm nëse auditori ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që çështja nuk është anomali materiale për PF. Një paragraf i tillë duhet t'ireferohet vetë informatave të prezantuara ose shpalosura në PF.

Paragrafi prandaj përdoret për të nënvizuar çështje fundamentale për shfrytëzuesit e PF. Nuk ka të bëjë me mosmarrëveshjen ose kufizimin e fushëveprimit dhe prandaj nuk është kualifikim i opinionit të auditorit. Paragrafi i theksimit të çështjes duhet qartë të theksoj se opinionin e auditorit nuk është modifikuar sa i përket çështjes së theksuar.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet të përfshijë referencë të qartë të çështjes e cila theksohet dhe referencë shpalosjes përkatëse në PF.

Shembuj janë ofruar në SNA 706 për situatat potenciale në të cilat përdoret paragrafi i theksimit të çështjes:

- Çfardo pasigurie lidhur me rezultatet e ardhshme të rasteve gjyqësore ose veprimeve rregullatore
- Aplikimi i hershëm i ndonjë standardi të kontabilitetit (në rast se lejohet) dhe që ka efekt të madh në PF.
- Një katastrofë e madhe që ka pasur dhe vazhdon të ketë efekt domethënës në pozitën financiare të entitetit.

(b) (i) Çështja e parë që duhet të përcaktohet është pavarësia e ekspertit. Kjo mund të jetë e vështirë nëse kjo është një fushë e ngushtë, veçanërisht në llojin e tregut në të cilin operon Stili. Na thuhet se Stili tashmë përdor ekspertët kryesorë të vendit, kështu që kjo mund të ngushtojë fushën në dispozicion të auditorit. Auditori duhet të sigurohet që eksperti nuk ka punuar për Stili, përndryshe eksperti mund të ekzaminojë vepra arti për të cilat ai ose ajo ka raportuar tashmë.

Eksperti do të duhet gjithashtu të deklarojë çdo punë të kryer për shitësit që furnizojnë Stili. Do të ishte për të ardhur keq nëse auditori do të mbështetej te një ekspert i cili kishte vlerësuar tashmë një vepër me qëllim që të këshillonte një shitës se sa duhet ta shesë atë vepër.

Eksperti do të duhet të konsiderohet i pranueshëm për Stili për shkak të çështjeve të sigurisë dhe konfidencialitetit që dalin. Auditori nuk mund t'i japë thjesht qasje një pale të tretë në të dhënat dhe pasuritë e klientit, veçanërisht kur ato pasuri janë të vlefshme dhe të lëvizshme.

Kualifikimet e ekspertit duhet të përcaktohen dhe të konsiderohen të përshtatshme. Mund të ketë kualifikime profesionale që mund të merren për lloje të ngjashme të vlerësimeve si dhe duhet të kontrollohet me kujdes anëtarësia e ekspertit në organizata profesionale.

Përvoja e ekspertit në ekzaminimin dhe vlerësimin e veprave të artit të kësaj natyre dhe cilësie do të jetë vendimtare. Mund të ketë shumë ekspertë që mund të përdoren për të kontrolluar vërtetësinë e artikujve të caktuar, por më të rrallët dhe më të vlefshëm do të kërkojnë ekspertizë të konsiderueshme.

(ii)

Auditorit i kërkohet të kryejë auditimin me aftësi dhe kujdes të arsyeshëm. Kjo është e vërtetë nëse puna është ndërmarrë nga vetë stafi i auditorit apo një palë e tretë. Stoqet vlerësohen me vlerën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe marzhat e fitimit janë përgjithësisht të mëdha. Kjo i siguron auditorit një fleksibilitet të madh për sa i përket komisionimit të një raporti mbi veprat e artit. Duhet të jetë e lehtë për ekspertin të lidhë çdo pjesë të caktuar me skedarin e blerjes pa pasur nevojë të përdorë rreze x dhe teste të tjera të gjera. Nuk ka gjasa që vlera neto e realizueshme e veprave të jetë më e ulët se kostoja e tyre, përveç nëse ka një të metë vërtetë të madhe të paregjistruar ose një falsifikim serioz. Përsëri, nuk ka gjasa që auditori do të kërkohet nga një ekspert që të shpenzojë një sasi të madhe kohe duke regjistruar pjesët me rreze X ose t'i nënshtrojë ato në analizë forenzike për të përcaktuar se është kështu.

Auditori gjithashtu duhet të marrë parasysh kosto-efektivitetin e evidencës. Fakti që mund të merret më shumë siguri nuk do të thotë gjithmonë se auditori duhet të përballojë koston shtesë që lidhet me këtë.

(iii)

Auditori duhet të pranojë përgjegjësinë e plotë për formimin e një opinionit në lidhje me pasqyrat financiare. Nuk do të ishte e përshtatshme t'i delegohej ndonjë përgjegjësi një pale të tretë.

Auditori duhet të informojë ekspertin siç duhet për të siguruar që janë mbledhur dëshmi të mjaftueshme. Auditori më pas duhet të sigurohet që raporti i ekspertit është kuptuar. Në rastin e auditimit të stoqeve të Stili, kjo mund të nënkuptojë t'i kërkohet ekspertit të sigurohet që auditori kupton çdo çështje teknike dhe vlerëson plotësisht shkallën në të cilën auditori i kupton kufijtë e gjetjeve të ekspertit.

Auditorit mund t'i duhet gjithashtu të sigurohet që eksperti e kupton plotësisht natyrën e evidencës së auditimit dhe shkallën në të cilën auditori dëshiron të mbështetet në të. Kjo mund të jetë e ndryshme nga përmbledhja e zakonshme e ekspertit, e cila mund të jetë më kërkuese se një auditim i jashtëm.

Detyra 4

(a) Qëllimi i SNA 510 *Auditimet fillestare – gjendjet (saldot) fillestare* është të themelojë një standard dhe ofroj udhëzime sa i përket gjendjeve fillestare kur pasqyrat financiare auditohen për herë të parë ose kur pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme janë audituar nga një auditor tjetër.

Kërkohet

Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit për raportim që është specifike për angazhimet fillestare.
(5 pikë)

(b) Kompania Lili Shpk ka pasur të hyra prej €10 milion dhe fitim prej €1.5 milion për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021. Mirëpo, kontabilisti i kompanisë ishte përjashtuar nga puna për shkak të keqpërdorimit të fondeve të kompanisë. Mashtrimi ishte kryer brenda pesë muajve gjatë vitit 2021, gjatë së cilës periudhë kontabilisti kishte pasur marrëveshje të fshehtë me njërin nga shitësit e kompanisë dhe me njërin nga personelin e agjencisë së pavarur për mbledhjen e borxheve në emër të Lili Shpk. Kontabilisti së bashku me këta persona kishte keqpërdorur €55,000 të pranuar nga afër 1,900 konsumatorë të Lili Shpk.

Mashtrimi ishte zbuluar gjatë një bisede biznesore në mars të vitit 2022, kur drejtori ekzekutiv i Lili Shpk kishte organizuar një drekë zyrtare me konsumatorët e kompanisë.

Drejtorët e Lili Shpk janë të sigurt se auditori i kompanisë ishte neglizhent gjatë punës pasi që kishte dështuar të zbulonte mashtrimin gjatë kohës së auditimit të pasqyrave financiare.

Auditorët theksuan se secili sistem i kontrollit të brendshëm i kompanive ka disa kufizime të vetëvetishme prandaj refuzojnë pretendimet se ishin neglizhent gjatë auditimit. Ata po ashtu pretendojnë se çfardo rishikimi i pavarur i letrave të punës së tyre do të konfirmonte se ata nuk ishin neglizhent gjatë kryerjes së auditimit.

Kërkohet:

Vlerësoni kufizimet e vetëvetishme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe gjithashtu edhe në procesin e auditimit. Konsideroni pse këto kufizime mund të rezultojnë me mos zbulimin e mashtrimit edhe nëse auditimi është kryer si duhet, ngjashëm sikur në rastin e mësipërm.

(15 pikë)

(Gjithsej 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Përgjegjësia e auditorit për angazhimet fillestare

Auditori duhet të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që saldot fillestare nuk përmbajnë anomali të cilat mund të ndikojnë në mënyrë materiale pasqyrat financiare të këtij viti. Auditori duhet po ashtu të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që politikat e kontabilitetit janë zbatuar me kosnsitencë. Nëse nuk mund të përftohet evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, raporti i auditorit duhet të rezervohet ose të refuzohet.

Nëse saldot fillestare përmbajnë anomali që mund të ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare, auditori duhet të informojë menaxhmentin e klientit dhe auditorin e mëparshëm. Nëse efekti i anomalive nuk trajtohet si duhet dhe nuk shpaloset, auditori duhet të jep një opinion me rezervë ose të refuzojë opinionin.

Nëse politikat e perudhës aktuale nuk janë zbatuar me konsistencë në saldot fillestare auditori duhet të jep një opinion me rezervë ose të refuzojë opinionin.

Nëse raporti i auditorit të vitit të kaluar ishte i modifikuar, auditori duhet të konsiderojë efektin në pasqyrat e këtij viti. Nëse modifikimi mbetet relevant dhe material për pasqyrat e këtij viti, raporti i auditorit për këtë vit duhet të modifikohet gjithashtu.

Duhet të përfshihet një paragraf i çështjeve tjera në raportin e auditorit nëse pasqyrat e vitit të kaluar nuk ishin audituar ose janë audituar nga një auditor tjetër. Kjo duhet të ndodhë pa marrë parasysh nëse janë ose jo me anomali materiale dhe po ashtu ky fakt nuk e liron auditorin të përftojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për saldot fillestare.

(b) Kufizimet në procesin e auditimit janë listuar më poshtë:

Kufizimet e vetëvetishme

Për shkak të kufizimeve të vetëvetishme të auditimit, auditorët mund të ofrojnë vetëm 'siguri të arsyeshme' mbi paraqitjen e drejtë dhe të sinqert të pasqyrave financiare dhe jo një siguri absolute.

Përdorimi i gjykimit profesional

Auditimi përfshin përdorimin e gjykimit në identifikimin e rreziqeve të auditimit, përzgjedhjen e procedurave të përshtatshme të auditimit dhe interpretimin e dëshmimeve të auditimit. Edhe pse standardet e auditimit ofrojnë udhëzues për ti ndihmuar auditorëve në formimin e një gjykimi solid profesional, është e pashmangshme që një auditor të gjykojë gabimisht një situatë që shkakton moszbulimin e ndonjë anomalie materiale në pasqyra financiare.

Përdorimi i mostrimit

Auditorët përdorin teknika të mostrimit për të limituar numrin e transaksioneve dhe saldove të përzgjedhura për të testuar në mënyrë që auditimi të kryhet me efektivitet dhe efikasitet. Rezultatet që dalin nga transaksionet dhe saldot e përzgjedhura mund të mos jenë përfaqësuese të popullatave. Prandaj ka një rrezik të vetëvetishëm që procedurat e auditimit të dështojnë të zbulojnë një anomali materiale në pasqyrat financiare për shkak të pamundësisë së auditorëve të kryejnë teste të detajuara në të popullatën e transaksioneve dhe saldove.

Përfaqësimet e menaxhmentit

Në përgjithësi, dëshmitë e jashtme konsiderohen më të besueshme se ato të pranuar nga brenda (të gjeneruara nga menaxhmenti). Edhe pse auditorët mbledhn dëshmi të auditimit nga një gamë e burimeve, shumë shpesh ata duhet të mëbshteten në përfaqësimet nga menaxhmenti për të vlrësuar arsyeshmërinë e çështjeve lidhur me pasqyrat financiare. Kjo është shumë e rëndësishme sidomos për çështjet që përfshijnë përdorimin e gjykimit nga menaxhmenti pasi që zakonisht është

vështirë të merren dëshmi vërtetuese për ato gjykime nga palët e jashtme. Rreziku nga mashtrimi për nga natyra është vështirë të zbulohet sidomos nëse ka marrëveshje të fshehta edhe nëse përdoren procedura shumë të mira të auditimit.

Pengesat kohore

Në praktikë auditorët ballafaqohen me pengesa kohore brenda të cilave duhet të ofrojnë opinionin e tyre mbi pasqyrat financiare. Auditorët kanë tendencë të ju japin përparësi detyrave që janë esenciale për performancën efektive të auditimit. Në disa raste, sidomos kur kompanitë ballafaqohen me kërkesa ligjore për publikimin e pasqyrave financiare të audituara në datë të caktuar, auditorët mund të dështojnë të konsiderojnë të gjitha fushat me rrezik duke ndjekur afatet kohore.

Kërcënimet e pavarësisë

Ndërsa udhëzuesit e etikës të publikuar nga IFAC dhe organizatat tjera profesionale tentojnë të minimizojnë rastet kur mund të dëmtohet objektiviteti i auditorëve, disa konflikte të interesit në praktikë janë të pashmangshme. Pavarësia e perceptuar e auditorit do të dëmtohet nëse të hyrat nga një klient përmbajnë një përqindje të madhe të të hyrave të auditorit..

Mbështetja në kontrollet e brendshme

Në shumicën e auditimeve, auditorët mbështeten në sistemet e kontrollit të brendshëm si burim kritik i dëshmive të auditimit. Mirëpo, sistemet e kontrollit të brendshëm kanë kufizime të vetëvetishme siç janë:

Shumica e sistemeve të kontrolleve të brendshme mbështeten në ndarje të detyrave të cila mund të anashkalohen përmes marrëveshjeve të fshehta në mes të punonjësve se në mes të punonjësve dhe personave të jashtëm.

Kontrollet e brendshme shpesh mbështeten në kontrolle të dyfishta, por edhe kontrollet e dyfishta mund të përmbajnë gabime njerëzore.

Kontrollet e brendshme janë të dobishme vetëm nëse janë efektive nga aspekti i kostos, prandaj nuk do të ishte mençuri nëse tentohen të ndalohen të gjitha gabimet dhe mashtrimet.

Kontrollet e brendshme në mënyrë tipike janë të disenjuara të trajtojnë transaksione rutinore që përsëriten, prandaj transaksionet jorutinore dhe të jashtëzakonshme mund të mos i nënshtrohet kontrolleve të duhura.

Kontrollet e brendshme ndonjëherë mund të anashkalohen nga menaxhmenti dhe atë në mënyrë specifike në organizata më të vogëla dhe organizata joqeveritare. Në rastin tonë do të ishte e vështirë për auditorët të zbulonin keqpërdorimin e fodeve për arsyet në vijim:

Shuma e mashtrimit është jomateriale në kontekstin e biznesit që është përafërsisht 3.67% e fitimit neto dhe 0.55% e të hyrave. Prandaj nuk do të ishte evidente në procedurat analitike të pasqyrave financiare.

Nuk kemi njohuri se si është kryer mashtrimi ose shtrirja e mbulimit nga kontabilisiti por nëse 55,000 Euro janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në 1,900 konsumatorë shuma që flasim për secilin konsumator është €29, në këtë kontekst shumat individuale janë të parëndësishme për të tërhequr vëmendjen e auditorit

Mashtrimi është kryer në vitin që përfundoi në dhjetor 2016 dhe është zbuluar në mars 2017. Kjo është relativisht periudhë e shkurt dhe nuk është e qartë nëse auditimi është finalizuar deri në kohën kur është zbuluar mashtrimi

Na është thënë se mashtrimi është kryer përmes marrëveshjeve të fshehta dhe e dimë që marrëveshjet e fshehta mund të minojnë shumicën e kontrolleve të brendshme sepse ato sisteme bazohen kryesisht në ndarje të detyrave

Në anën tjetër duket se janë dy anë të marrëveshjeve të fshehta, njëra me shitësin dhe tjetra me agjencinë për grumbullimin e borxheve. Ky është një rast i mashtrimit që duket shumë i vështirë për tu zbuluar.